

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 68 nga Rregullorja gjyqësore (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.66/2013 dhe 114/2014), dhe nenin 31, nenin 32 dhe nenin 33 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/2022 të datës 20 janar 2022), duke shqyrtuar për mendimin juridik me interes për unifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatave të Apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 28.02.2022, miratoi këtë:

## **MENDIM JURIDIK**

**Shoqëria e avokatit nuk ka legjitimacion aktiv për udhëheqjen e një kontesti në bazë të kërkesave të mëparshme nga avokatët – themelues të shoqërisë së avokatit, në qoftë se atë kërkesë të cilën themeluesit e kanë fituar si avokatë individ nuk e kanë theksuar në vendimin për themelimin e shoqërisë së avokatit.**

## **A r s y e t i m**

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është parashtruar kërkesë për sigurimin e barazisë në zbatimin e ligjeve nga Gjykatat e Apelit Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip, lidhur me çështjen juridike: “A mundet që një shoqëri e avokatit të ketë një legjitimacion aktiv për udhëheqjen e një kontesti në bazë të kërkesave të mëparshme nga themeluesit e të njëjtës, në një situatë kur këta themelues kërkesën e tyre të fituar si avokat individ, me asnjë akt nuk ia kanë bartur shoqërisë së avokatit”.

Në shtojcë të iniciativës janë dorëzuar dy vendime, njëri i Gjykatës së Apelit Gostivar GZH.nr.1358/19 të datës 26.12.2019 dhe i dyti, i Gjykatës së Apelit Manastir GZH.nr.1508/2013.

Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Gostivar GZH.nr.1358/19 të datës 26.12.2019, del se gjykata ka pranuar se shoqëria e avokatit Tomisllav Kuzmanoski nga S. ka legjitimacion aktiv për udhëheqjen e një kontesti në bazë të kërkesës së mëparshme nga njëri nga themeluesit e shoqërisë së avokatit – Branko Kuzmanoski, avokat nga S., edhe pse ky avokat kërkesën e tij, që e ka fituar si avokat individ nuk ia ka bartur shoqërisë së avokatit Tomisllav Kuzmanovski nga S..

Qëndrimin e këtillë gjykata e mbështet në rrethanën se gjatë ndryshimeve është vënë re vazhdimësia në kryerjen e veprimtarisë së avokatit me bashkimin e të njëjtit avokat individ Branko Kuzmanoski nga S., në shoqëri të avokatit së pari të Branko Kuzmanoski nga S, e më pas në shoqërinë e avokatit Tomislav Kuzmanoski nga S., në pajtim me aktvendimin e Odës së avokatëve, si dhe me ndryshimet e bëra në Regjistrin Qendror. Gjykata pranon se nuk bëhej fjalë për ndërprerje të veprimtarisë si avokat, por për një ndryshim të statusit me zgjerimin në shoqëri të avokatit, në mënyrë që në ndryshimet e bëra kishte vazhdimësi në kryerjen e të njëjtës veprimtari me ndryshimin nga një avokat individ në një shoqëri të avokatit, nga ku në fakt janë bartur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e avokatit të atëhershëm individ Branko Kuzmanoski nga S., në shoqërinë e formuar të re të avokatit Tomisllav Kuzmanoski nga S.. Për këto shkaqe, Gjykata e Apelit Gostivar konsideron se nuk ka pengesë që shoqëria e avokatit Tomislav Kuzmanoski nga S. në rastin konkret të paraqitet si paditës i kërkesës që

vjen nga marrëveshja e lidhur për huazim të mjeteve në para nga avokati individ i atëhershëm Branko Kuzmanoski nga S. me të paditurit A. M. dhe V. M. 1, që të dy nga fshati S. S.

Në kundërshtim të kësaj, nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Manastir GZH.nr.1508/13 të datës 23.12.2013, rezulton se kjo gjykatë ka pranuar se Shoqëria e avokatit Veritas nga M., nuk është e legjitimuar aktive që të parashtrijë padi dhe të kërkojë nga i padituri në atë procedurë Petar Hristovski nga M., që t'ia paguajë shumën e kërkuar, ngase avokati Nikolla Dabiq nga M., me asnjë akt kërkesën e tij, të cilën e kishte fituar si avokat individ nuk ia ka bartur paditësit, shoqërisë së avokatit Veritas nga M., që të mundet tani kjo shoqëri e avokatit si kreditor në kuptim të dispozitave të Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Ligjit për falimentim që shumën ta kërkojë me padi. Ajo që ky avokat ka kaluar si avokat themelues në shoqërinë e avokatit Veritas nuk do të thotë se ia ka bartur kërkesën e tij, të cilën avokati Nikolla Dabiq e ka pasur ndaj N. DOOEL nga M.. Më pas, Gjykata e Apelit Manastir në vendimin e më sipër theksuar i referohet marrëveshjes për themelimin e shoqërisë së avokatit Veritas të datës 01.09.2012 dhe tregon se depozitimi themelues i shoqërisë së avokatit Veritas ka qenë shuma prej 8.960 euro ose 548.760,00 denarë, e cila ishte vlera e vlerësuar e mjeteve të theksuara në marrëveshjen. Në marrëveshjen, nuk është theksuar se ndonjëri nga themeluesit: N.S., N.D. ose V.S, i bartin kërkesat e tyre që i kanë fituar me kryerjen e veprimtarisë autonome si avokatë. Kjo që paratë kanë kaluar në një llogari të vetme të shoqërisë së avokatit Veritas nga M., nuk do të thotë se paditësi shoqëria e avokatit Veritas nga M. ka edhe legjitimacion aktiv.

Në shtojcë të vendimit të sipër cituar, të Gjykatës së Apelit Manastir është edhe njoftimi i Gjykatës së Apelit Manastir SU.nr.03-32/21 të datës 02.04.2021, ku një qëndrim të këtillë si Gjykata e Apelit Manastir lidhur me të njëjtën çështje juridike ka marrë edhe Gjykata e Apelit Shtip, që rezulton nga njoftimi i konkluzionit të kësaj gjykate SU.nr.696/20 të datës 28.09.2020.

Nga e sipër cituara, rrjedh se për të njëjtën çështje juridike ka praktikë të ndryshme gjyqësore ndërmjet Gjykatës së Apelit Manastir nga njëra anë dhe Gjykatës së Apelit Shtip nga ana tjetër.

Për të zgjidhur këtë çështje juridike duhet të merret parasysh Ligji për avokaturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.59/2002) dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.60/06 dhe "Gazeta zyrtare e RM" nr. 113/12). Kjo për arsye se bëhet fjalë për Ligj – Ligji për avokaturë që është lex specialis.

Sipas nenit 6 paragrafi (1) të Ligjit të theksuar: "Veprimtarinë e avokatit e kryejnë veçanërisht avokatë që e kanë dhënë betimin dhe janë regjistruar në Regjistrin e Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë".

Në nenin 6 paragrafi (2) së të njëjtit Ligj thuhet: "Avokatët e kryejnë veprimtarinë e avokatisë si avokatë individ dhe avokatë të bashkuar në shoqëri të avokatit".

Ndërsa sipas nenit 6 paragrafi (3) nga Ligji i cituar: Avokatët individ regjistrohen në Regjistrin e avokatëve, ndërsa shoqëritë e avokatëve regjistrohen në Regjistrin e shoqërive të avokatëve, që mbahen në Odën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë".

Në nenin 7 paragrafi (1) të Ligjit për avokaturë qëndron: "Avokati individ e kryen veprimtarinë e avokatit individualisht".

Sipas nenit 8 paragrafi (1), paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (5) nga i njëjti Ligj: "Dy ose më shumë avokatë mund të themelojnë shoqëri të avokatit. Shoqëria e avokatit kryen veprimtari të avokatit si avokat individ. Shoqëria e avokatit themelohet me vendim për

themelim. Shoqëria e avokatit regjistrohet në Regjistër të shoqërive të avokatëve, që udhëhiqet në Odën e avokatëve të Republikës së Maqedonisë me çka fiton statusin e personit juridik në pajtim me këtë Ligj”.

Nëse merren parasysh këto dispozita rrjedh se, kur bëhet fjalë për shoqëri të avokatit e njëjta themelohet nga dy ose më shumë avokatë edhe atë me vendim për themelim. Në vet vendimin për themelim, doemos duhet theksuar nëse ndonjëri nga themeluesit gjatë themelimit të shoqërisë së avokatit i bart kërkesat e tij që i ka fituar si avokat individ. Në qoftë se, kjo nuk është bërë, shoqëria e avokatit nuk mund të paraqitet si paditës për kërkimin e njërit nga themeluesit të shoqërisë së avokatit, të cilën themeluesi e ka fituar si avokat individ.

Qëndrimi i Gjykatës së Apelit Gostivar, i shprehur në vendimin e më sipërm, se për shkak që ka vazhdimësi në kryerjen e veprimtarisë së njëjtë nuk ka asnjë pengesë që shoqëria e avokatit të paraqitet si paditëse për një kërkesë, të cilën e ka pasur si avokat individ, njëri nga themeluesit e shoqërisë së avokatit, nuk ka asnjë mbështetje as në aktvendimin e Regjistrimit Qendror të RM numër 0805-50/150220180009333 të datës 17.12.2018. Në fakt, në këtë aktvendim qëndron: “Me aktvendimin numër 04-901/1 të datës 04.01.2013 nga Oda e Avokatëve të RM Shkup në Regjistrin e avokatëve me numër rendor 431 të avokatit Branko Kuzmanoski nga S. i ndërpritet e drejta e kryerjes së veprimtarisë së avokatit si avokat individ duke përfunduar me 31.12.2012 dhe i njëjti vazhdon me kryerjen e veprimtarisë së avokatit si avokat themelues i shoqërisë së avokatit Branko Kuzmanoski nga S.. Do të thotë se, ai më nuk kryen veprimtarinë e avokatit si avokat individ, por kryen veprimtarinë si avokat themelues i shoqërisë së avokatit Branko Kuzmanoski, shoqëri kjo e cila më vonë me aktvendim të Regjistrimit Qendror të RM të datës 09.10.2018 e ka ndryshuar emrin në shoqëri të avokatit Tomisllav Kuzmanoski nga S..

Kjo gjykatë sugjeron se avokati individ nuk konsiderohet tregtar në pajtim me nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit për shoqëritë tregtare, për arsye se veprimtaria e tij nuk mund të konsiderohet si tregtare në pajtim me dispozitat e nenit 4 nga ligji i sipërcituar, ashtu që as shoqëria e avokatit nuk është shoqëri tregtare. Për këto arsye, për avokatët individ dhe për shoqëritë tregtare nuk mund të zbatohen dispozitat e Ligjit për shoqëri tregtare, që i zbaton Gjykata e Apelit Manastir në vendimin e cituar, por veçanërisht zbatim gjen Ligji për avokaturë si lex specialis.

Nga e sipër prezantuar, vijonte të miratohet ky mendim juridik.